



Data: 18.05.2018

Ref.: 432/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 53-të, të mbajtur më 22 Shtator 2017, mori:

#### V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Kolegjit “Heimerer” për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.573/17, datë: 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr. 573/17, datë: 06.07.2017, për programet e studimit:
  - Pedagogji Profesionale në Shëndetësi/ Fushë Profesionale e Infermierisë, BSc, 180 ECST.
- III. Lejohet regjistrimi i studentëve në programin e cekur në pikën dy të këtij vendimi.

#### A r s y e t i m i

Kolegji “Heimerer” me datë: 07.09.2017, ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së, nr.573/17, datë: 06.07.2017, me të cilin vendim Kolegjit “Heimerer”, i është pezulluar akreditimi për tri programe studimi të cekura në vendimin përkatës.


Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji “Heimerer” është konstatuar që programet e cekura në pikën dy (II) të këtij vendimi, i plotësojnë kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë: 20.09.2016, neni 11, pika 3.2. Sipas kësaj pike, Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) duhet të ketë të paktën tre persona në marrëdhënie të rregullt pune të nivelit PhD për secilin program të studimit.

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me datë: 22 Shtator 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Heimerer"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

